


Republika e Shqipërisë  
Dhoma e Noterisë Tiranë



Nr. 1754 Rep.

Nr. 273 Kd.



## KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME (Lloji kuota)

Sot me date 14/09/2018 (dymije e tetembedhjete), para meje noteres Marsela V. Veseli, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me zyre ne adresen Blv. "Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme per redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

### SHITESI:

**Z. ELVIS BELULI**, atesia Sami, i datelindjes 07/11/1990, lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane, Kamez, Rr. "Dituria", madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr. 033217075, me Nr. Personal J01107091F, ne cilesine e ortakut te Shoqerise "**ALBANIA STONE**", **Sh.p.k.**, e regjistruar si person juridik me date 17/08/2017, e identifikuar me NIPT L732170011, me seli Berat Otlak ORIZAJ Fshati Orizaj, Rruga Antipatrea, Ndërtesë një katëshe, Zona Kadastrale 2833, Pasuria nr.1350/81.. (më poshtë i quajtur "Shitesi" )

### BLERESI:

**Z. DORJAN NAKO**, atesia Vladimir, i datelindjes 02/08/1992, lindur ne Çorovode, Skrapar dhe banues ne Tirane i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes Nr. B11820703, me numer personal **J20802085D**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.(më poshtë i quajtur "Bleresi").

Shitesi dhe Bleresi, referuar të dy së bashku do të quhen "Palët".

### Të përgjithshme

Shitesi është zotërues i 1 kuote me vlere 100 000 Lek, qe perben **100 (njeqind) %** te kapitalit të Shoqërisë "**ALBANIA STONE**", **Sh.p.k.** (më poshtë referuar si shoqëria.)

Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njeqind mije) lek.

Në përputhje me "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e Shitjes", hartohet kontrata e Shitjes si më poshtë vijon:

### Neni 1

#### Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Shitesi i kalon Bleresit pronesine mbi 1 kuote me vlere 50% te kapitalit themeltar si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

### Neni 2 Çmimi i Shitjes

Çmimi i shitjes së kuotes është caktuar ne vleren **50 000 (pesedhjetë mijë) leke**. Kjo vlere eshte paguar nga Bleresi jashtë kesaj zyre noteriale dhe palet nuk paraqesin asnje pretendim ne lidhje me kete.

**Neni 3  
Garancitë**

Shitesi në lidhje me kuoten që zotëron, garanton Bleresin :

- Se është pronar i vetem i kuotes qe shet.
- Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuoten e fituar në shoqëri do të mund të ushtrohet rregullisht.

**Neni 4  
Kalimi i pronesisë**

- Kalimi i pronësisë mbi kuoten do të kryhet menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate. Regjistrimi i kalimit të kuotes do te kryhet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Personi që kalon kuoten dhe ai që e fiton ate, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga Çasti i kalimit të kuotes deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

**Neni 5  
Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

**Neni 6  
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do te jete *Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane*.

**Neni 7  
Të ndryshme**

Kontrata iu lexohet palëve, të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar). Në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kontrata redaktohet në 4 ekzemplarë, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilët dy ekzemplarë janë për Blerësin dhe nje për shitësin. Një ekzemplar do të ruhet ne arkiven e noterit.

Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimeve, në bazë të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

**PALET KONTRAKTUESE**

**SHITESI**

*Elvis Belali*

*[Signature]*

**Notere**  
*Marsela Veseli*

**BLERESI**

*Dorian Woko*

*[Signature]*

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-201809141131270  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 14.09.2018  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:31:27AM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-561-447  
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ALBANIA STONE SH.P.K.

